

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, me Zyrtaren Ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit R.Bi nga fsh.L,K, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.523/17 e datës : 29.03.2017 të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, pas mbajtjes së seancës gjyqësor, më datën 19.04.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T V E N D I M

I pandehuri R. Bi nga i ati Rdhe nëna Ne, e lindur H, i lindur më datë në Gjilan ku tani jeton në fsh.L.e ka të kryer shkollën e mesme special në Prizren për shurdh-memec, din shkrim lexim, i martuar baba i një fëmiu, i pa punë me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor Sepse

-Me datën 25.03.2017, rreth orës 23.50 minuta, në shtëpinë e tij fsh.i, i dyshuari pas një mosmarveshje fillimisht verbale rreth një telefoni me të dëmtuarën motrën e tij M. B të njëjtën e sulmon edhe fizikisht të cilën e kap fillimisht për flok dhe pasi e njëjta rrëzohet për tok, e godet me shkelm në kokë, dhe për pasoj i shkakton lëndime të lehta trupore, të përshkruara si në raportin mjekësorë me numër ...të datës 26.03.2017, lëshuar nga Emërgjensa e Spitalit Regjional të Gjilanit.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit të lartëcekur pastaj të neneve 89 të KPRK-së dhe neneve 365,454,512,513 E 514 të KPRK-së, atij i shqipton:

MASEN E TRAJTIMIT TË DETYRUSHËM PSIKIATRIK NË LIRI

Të cilën mas do ta implementoj në Qendrën e shëndetit mendor në Gjilan, të cilën e menagjon drejtori Dr., kohë për kohë do ta informoj gjykatën me shkrim , mbi rrjedhën e shërimit të të njëjtit.

Shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë lëndë bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan për krime të Përgjithshme, ka parashtruar propozimin e vet për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, PP.II.nr.523/17 të datës 29.03.2017 ndaj të pandehurit R.B nga fshati, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 19.04.2017, ku haptazi u pa dhe u vërtetua se i pandehuri kishte pengës serioze sa i përket shëndetit të tij mendor e fizik, konstatim ky i mbështetur krye këput me mendimin dhe vlersimin e dhënë në seanc nga mjeku specialist i psikiatris Dr.Afrim Cana i cili pos tjerash pohoi,, Unë i njoftuar për rastin konkret sepse qysh nga viti i kaluar personi në fjalë është duke u shëruar tek unë në shërbimin tim, për shkak të defekteve të tija në komunikim, pasi që dihet ky është shurshë memec, i njëjti gjithmonë shoqërohet nga bashkëshortja e tij dhe rregullisht vie në konsult.

Arsyja pse ky është duke u trajtuar, janë pikërisht defektet që së fundëmi është duke i manifestuar në kuptim të pamundësis së kontrollit adekuat të sjelljeve të tija , në veqanti në ambientin e tij primar në familje, të cilat sjellje her pas here manifestohen edhe me agresivitet për të cilat ai veq është duke u trajtuar, dhe bazuar nga të dhënat që na ka ofruar bashkëshortja e tij dhe vet klienti, ka pasur shenja të përmisimit , dhe ky trajtim përderi sa ky e përdor terapinë me rregull besoj se rezultati do të jet pozitiv, i suksesshëm , bazuar në atë se ky është shudhë memec nga pas lindja e tij, me vazhdimsi i ka muhuar atij mundësin që të jet i barabart në ndërveprim, në rend të par në ambientin e tij primar, e më pastaj edhe në rrethin e tij të gjer.Por duke pas parasysh faktin se kjo kategori nuk ka përkujdesje adekuate në kuptim të afërmit të mundësis së edukimit adekuat dhe mënyren e sjelljeve që do ti mundësonin funksionim të pavarur gjatë jetës së tij , kjo rrethan më pastaj ka ndikuar direkt, që këta individ, në fazat e ndryshme gjatë jetës së tyre të manifestojmë qoftë edhe sjellje agresive.Gjithnjë duke i marrë për bazë këto fakte, se është hera e parë që i pandehuri është pranë gjykatës , dhe fakti se i njëjti është në trajtim e sipër te unë , i propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, e jo aja e propozuar nga prokuroria, përfundoi eksperti psikiatër Dr.Afrim Cana.

Prokurorja e Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, në fjalën e saj në seanc, mbetet në tërësi pran propozimit të propozuar me shkrim, duke pohuar se propozimi i dr.Afrim Cana, për rastin konkret është mas e butë.

Me propozim e PSH u pajtua edhe e dëmtuara, si dhe përfaqësuesi i mbrojtësit të viktimave B. P duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet propozimi i Prokurorit të Shtetit.

Mbrojtësi i të pandehurit R. B, av B. H, avokat nga Gjilani, pohoi se i bashkangjitet propozimit të dr.Afrim Cana, e që pohoi se propozimi i tij të aprovohet, ndërsa të refuzohet propozimi i prokurorit të shtetit.

Nga gjendja faktike në gjykat, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të asaj që e laburoi eksperti psikiatërt Dr.Afrim Cana, në një anë, dhe në bazë të propozimit me shkrim të prokurorit të shtetit, pamjes vizuale të të pandehurit Remzi Bajrami, veprën penale me të cilën ngarkohet, e kishte kryer në rrethana të gjendjes jo të shëndetshme fizike e psiqike, vendosi që ta aprovoj propozimin e dhënë me gojë nga eksperti psikiatër dr.Afrim Cana, të ia shqiptoj atij masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, ndërsa nuke aprovoi-refuzoi propozimin e prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës më të ashpër ate të trajtimit psikiatrik me ndalim, duke u bazuar nga fakti se i njëjti edhe më par nuk është i njoftur për gjykatën, në shikim të par në gjykatë është shumë i qet, jo i dhunshëm, se është në trajtimin e sipër të dr.Afrim Cana, i cilin edhe propozoi këtë trajtim të cilin edhe veq të njëjtin është duke e trajtuar, duke shpresuar se i njëjti, do të shërohet edhe më këtë tretman të tanishëm.

Ushtrimi mbi shpenzimet e procedurës penale , është i bazuar në nenin 454 të KPRK-së .

Andaj, duke u bazuar nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, konform neneve 89 të KPRK-së si dhe të neneve 365.512,513 e 514 të KPRK-së

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.315/17 Më datë 19.04.2017

Zyrtarja Ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Florentina Ademi

Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*

